

STATUTI I SHOQERISE  
DHE  
AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"A.M.A.S" Sh.p.k.

Shtetasit Anton Grrica , i lindur me 24.10.1995, ne Bulqizë identifikuar me ane te Kartes se identitetit J51024008Q, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Shtetasit Etmond Grrica , i lindur me 22.06..1985, ne fshatin Peshk te Bulqizë identifikuar me ane te Kartes se identitetit I50622006F, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Shtetasit Artan Grrica , i lindur me 05.03.1994, ne fshatin Peshk te Bulqizë, identifikuar me ane te Kartes se identitetit J40305011Q, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Shtetasit Silvan Grrica , i lindur me 07.08.1982, ne fshatin Peshk te Bulqizë, identifikuar me ane te Kartes se identitetit I20807008S, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Krijojë sotë me datën 01.06.2024 Shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar: "A.M.A.S" Sh.p.k. me seli ne Rruga Arberit zone kadastrale 3426 nr pasurie 784/5"; Tirane. Statuti është akti baze ku do te mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "A.M.A.S" Sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

1.1 Ortaket i kesaj shoqerie Z. Anton Grrica, Z. Etmond Grrica, Z. Artan Grrica, Z. Silvan Grrica jane zoteruesit 100 % te kapitalit te shoqerise. Ne perqindje e aksjoneve si me poshte:

1. Anton Grrica do te zoterojne 25% te aksjoneve.
2. Etmond Grrica do te zoterojne 25% te aksjoneve
3. Artan Grrica do te zoterojne 25% te aksjoneve
4. Silvan Grrica do te zoterojne 25% te aksjoneve

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

2.1. Shoqeria mban emrin "A.M.A.S" Sh.p.k dhe eshte person Juridik Shqiptar.

2.2. Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në aktin e themelimit dhe statutit, si dhe në kontratat respektive.

### NENI 3

#### SELIA E SHOQËRISË

3.1. Shoqëria "A.M.A.S" Sh.p.k, me seli në Rrugë Arberit zone kadastrale 3426 nr pasurie 784/5"; Tiranë.

### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

4.1. Objekti i Veprimtarisë Shoqërisë është :

Prodhim i mbulesa një përdorimshe, letrave higjienike, katëpiceta etj, Tregti me pakicë e shumicë të artikujve të ndryshëm.

4.2. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konformë me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga ortakët e saj.

4.3. Shoqëria mund të zgjerojë, ndryshojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë, kjo e bazuar në vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë "A.M.A.S" Sh.p.k.

### NENI 5

#### PERGJEGJESIA E ORTAKUT TË VETEM

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësive të ortakut të shoqërisë "A.M.A.S" Sh.p.k

5.2. Ortakët e shoqërisë, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, përveç kapitalit themelues të saj, që vetë kanë nënshkruar, gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të shoqërisë .

### NENI 6

#### KOHEZGJATJA

6.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohë të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

### NENI 7

## SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "A.M.A.S" Sh.p.k

### KREU II

#### NENI 8

### KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "A.M.A.S" Sh.p.k. eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 100.000 (nje qindemije) leke

8.2. Shoqeria "A.M.A.S" Sh.p.k perbehen nga 4 (kater) kuotë, me vlere nominale 1 (nje) kote eshte barbarte me 25.000 (njzetepesemije) leke.

8.3. Ortaket zoterues te aksjoneve, Anton Grrica zoterrojne 25%, A Etmond Grrica zoterrojne zoterrojne 25%, Artan Grrica zoterrojne 25%, Silvan Grrica zoterrojne 25%, qe pergjigjet per humbjet e shoqërisë përkundrejt te treteve deri ne vlerën e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

#### NENI 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku ne favor te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posaçem.

9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100.000 (nje qindmije) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakve te shoqerise dhe sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne shërbime, nëpërmjet emërimit te një eksperti te autorizuar për këto kontribute.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeut te shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendmi per zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit



## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit t". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## NENI 11

### ORGANI VENDIMARRËS

**11.1. Asambleja e Ortakëve** është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.


**11.2. Ortaket**, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;



- c) investime;
- ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 12

### ADMINISTRATORI

12.1. Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë orokëve.

12.2. Administrator i shoqërisë u vendos Z. Anton Grrica me k. Idetiteti J51024008Q

12.3. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 4 vjeçar duke nisur nga data e themelimit 01.06.2024 e në vazhdim, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Administratori mund të zevendesohet edhe pa mbaruar mandatin, në nqs dorheqje apo për arsye të ndryshme me vendim të asamblese së ortakve, për largimin dhe emerimin e administratorit të shoqërisë.

## NENI 13

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ai vetë.
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatitjen dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakve të shoqërisë në mbledhjen e asamblesë së ortakëve.
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

**13.2** Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**13.3** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

**13.4.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

#### NENI 14

#### VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### NENI 15

#### BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

**15.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme, e përberë nga Ortaket miratojnë bilancin e paraqitur nga Administratori.

**15.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga Ortaket vendosin rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar nqs ka, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### NENI 16

#### MBARIMI I SHOQERISE

**16.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakeve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) Me vendim të gjykatës;

**16.2.** Ne këtë rast, Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo

dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

**16.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagues, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**16.4.** Nëse Ortaket e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### NENI 17

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

**17.1.** Transformimi i shoqërisë behet me vendim te Ortakeve ose kur ekzistojnë faktorë te jashtëm detyrues ligjore, ne këto raste vendimi merret pasi i është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

**17.2.** Çdo transformim i bere ne kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

#### NENI 18

### BAZA LIGJORE

**18.1.** Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**18.2.** Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve te tjera ligjore dhe nënligjore te dale ne zbatim te tyre ne Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 19

### MOSMARRREVESHJET

**19.1.** Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

**19.2.** Ne rast te kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tirane.

#### NENI 20

### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

**20.1.** Ky statut është hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te Ortakve te shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

20.2. Ky Statut u redaktua ne katër kopje, ne gjuhen shqipe. Një kopje mbahet ne dokumentacionin baze te shoqërisë.

**Ortaket Themelues "A.M.A.S" Sh.p.k**

Anton Grrica



Etmond Grrica



Artan Grrica



Silvan Grrica



Tirane me 01.06.2024